

VENDIM
Nr. 374, datë 1.6.2022

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 17, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, të bëhet rishpërndarje e fondeve ndërmjet programeve buxhetore, si më poshtë vijon:

a) në programin buxhetor “Mbështetje shëndetësore” 07340 të shtohet fondi prej 91 000 000 (nëntëdhjetë e një milionë) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”;

b) në programin “Mbështetja e luftimit” 02150 të pakësohet fondi prej 91 000 000 (nëntëdhjetë e një milionë) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”.

2. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj